



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (e) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, më 10.04.2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Refuzohet kërkesa e Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Junik**, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit komunal z.Lulzim Gacaferi, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet kryesuesit të Kuvendit Komunal në Junik z.Muharrem Krasniqi.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 02.04.2019, 240/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit komunal z. Lulzim Gacaferi, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, për arsye të mungesave të tij në mbledhje të kuvendit duke filluar nga data 31.10.2018, 30.11.2018, 28.12.2018.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 10.04.2019, nr 03/2019, pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitur ka konstatuar se kërkesa e refuzohet si e pa bazuar, për arsye se bazuar në nenin 37.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, zëvendësimi i anëtarit në rast mungesë tre muaj rresht, bëhet nëse nuk ka arsye për mungesat e tije.

Në rastin konkret është vërtetuar përmes vërtetimit të lëshuar për paaftësisë për punë, i datës 28.12.2018, përmes të cilit është konstatuar se z.Lulzim Gacaferi, ka pasur probleme shëndetësorë.

Andaj, KQZ-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 10.04.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

